

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik ☐

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)* ☐

CLASS ASHENSOR

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

L01325010Q

NUIS/NIPT

Njesia Administrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selite.  
Adresa

Tiranë

Albania

1056

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0682027948

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

class.ashensor@yahoo.com

E-mail

ENKELEDI GROBALLI Enkeledi Groballi

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

2025/07/31

Data (viti/muaji/dita)

0682027948

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-55989-07-23-2025

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

---

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Simple

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*

Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a

---

Vlera e përllogaritur e prokurimit

*Vlera e përllogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

5000000

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2025/08/04

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme) ☐

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës) ☐

Tipi i kontratës

Shërbime

Data e zhvillimit të procedurës

2025/08/04

Numri i njoftimit

CN/74425/07232025

Kodi CPV

42416100-6

Ankese mbi argument në KPP

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.) ☐

Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 110, 111, dhe 114 pika 3 shkronja “a”, si dhe V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenet 41 pika 2 dhe 97 pika 1, shkronja “b” dhe pika 5.

#### 2. Objekti i ankesës ☐

- Modifikim i dokumentave të tenderit

☒

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

☐

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

☐

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate ☐

☐

*(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)*

- Tjetër ☐

☐

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** ☐

*Përshkruani rrethanat e faktit.* ☐

A.K. OPERATORI I SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE GROUP SH.A. ka publikuar në datën 24.07.2025, procedurën e prokurimit të llojit: E hapur, e thjeshtuar – Shërbime, Marrëveshje Kuadër me afat 3 vjeçar, me Nr.REF-55989-07-23-2025, në S.P.E. e A.P.P. me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve” dhe fond limit prej 4,783,050 (kater milion e shtateqind e tetëdhjetë e tre mije e pesëdhjetë)Lekë pa TVSH.

Tek KRITERET E VEÇANTA Të KUALIFIKIMIT / Kapaciteti Teknik pika 2.3.3. është përcaktuar se;

“...2.3.3. Operatori ekonomik duhet të provojë që cdo pjesë furnizim vendosje (referuar preventivit të shërbimeve shtojca 7 e DT) duhet të ketë origjinë nga prodhuesi në përputhje me specifikimet teknike të ashensoreve që parashikohet të mirembahen sipas Shtojcës 5 të DT. Kjo e vertetuar me autorizim mbështetje me pjesë kembimi, leshuar nga prodhuesi / distributori i autorizuar në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës...”.

Për sa më sipër kërkojmë rishikimin dhe heqjen e kriterit që kërkon autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës .

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

A.K. OPERATORI I SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE GROUP SH.A. ka publikuar në datën 24.07.2025, procedurën e prokurimit të llojit: E hapur, e thjeshtuar – Shërbime, Marrëveshje Kuadër me afat 3 vjeçar, me Nr.REF-55989-07-23-2025, në S.P.E. e A.P.P. me objekt: “Mirembajtje 3 vjecare e ashensoreve” dhe fond limit prej 4,783,050 (kater milion e shtateqind e tetëdhjetë e tre mije e pesëdhjetë)Lekë pa TVSH.

Afatet ligjore

Pra shpallja/publikimi i Njoftimit të Kontratës është kryer më datën 24.07.2025, në S.P.E. e A.P.P. Në nenin 110 pika 1 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”, të ndryshuar, përcaktohet se, citojmë:

“1. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

Po ashtu në nenin 97 pika 1 gërma “b” të V.K.M nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikohet se:

“1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor :

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar?”.

Gjithashtu po në nenin 97 pika 5 (shtuar pika 5 me V.K.M.-në nr. 498, datë 01.08.2024) të V.K.M nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), parashikohet se:

“?5. Në llogaritjen e afateve për paraqitjen e ankesës, sipas përcaktimeve në këtë nen nuk do të përfshihet dita e publikimit të njoftimeve përkatëse?”.

Procedura e prokurimit objekt ankese është një procedurë prokurimi nën kufirin e lartë monetar, dhe publikimi i njoftimit të kontratës të kësaj procedurë prokurimi është publikuar në sistemin e prokurimit publik (S.P.E.) në datën 24/07/2025, dhe se nga llogaritjet e kryera rezulton se ne si O.E. ankimes kemi respektuar afatin ligjor 7 ditor të paraqitjes së ankesës pranë Autoritetit Kontraktor dhe K.P.P.

Gjithashtu ne si O.E. legjitimohemi për të paraqitur ankesë përpara A.K. dhe K.P.P. sepse kemi si objekt të veprimtarisë objektin e tenderit. Ky objekt veprimtarie mund të verifikohet duke aksesuar faqen zyrtare të Q.K.K. me të dhënat e subjektit tonë (NIPT-in L01325010Q)

Në vijim të arësytimit tonë kërkojmë ndryshimin dhe heqjen e kriterit të vendosur nga A.K. tek pika 2.3.3. e Kriterëve Teknike pjesë e KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT që kërkon autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar në emër të operatorit ekonomik pjesëmarrës. Kriteri në fjalë është i pajustificuar dhe diskriminues , pasi:

- Emri tregtar i ashensorit (në këtë rast “KLEEMANN”) është i përvecëm, ndërsa komponentët që përbëjnë ashensorin janë të prodhuar jo vetëm nga Kleemann por nga kompani të ndryshme, gjë e verifikueshme në çdo moment përmes dokumentacionit teknik, stampave fizike dhe certifikatave CE të tij;

- Ky kriter kufizon padrejtësisht pjesëmarrjen në garë të operatorëve ekonomike , duke shkelur parimet e konkurrencës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi duke sjelle përjashtimin të operatorëve që ofrojnë, shesin dhe montojnë produkte cilësore dhe të certifikuara CE.

- Kërkesa nuk qëndron as teknikisht, as ligjërisht, dhe bie ndesh me parimin e konkurrencës së ndershme dhe proporcionalitetit, siç përcaktohet nga L.P.P.

Pra në përfundim të parashtrimeve;

## NË PËRFUNDIM KËRKOJMË

Për gjithë sa më sipër, referuar ligjit të prokurimit publik, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, i kërkoj A.K. OPERATORI I SHPERNDARJES SE ENERGJISE ELEKTRIKE GROUP SH.A.:

? Shqyrtimin e ankesës së Operatorit Ekonomik “CLASS ASHENSOR” Sh.p.k., si e paraqitur brenda afateve të parashikuara nga ligji.

? Rishikimin e kriterit pika 2.3.3. e Kriterëve Teknike pjesë e KRITEREVE TË VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, heqjen e tij, ose zëvendësimin me kërkesa të verifikueshme si:

dokumentacion teknik, certifikata të konformitetit ose përputhshmëri me standardet europjane EN 81-20/50 dhe në zbatim të VKM 1056 datë 23.12.2020, Për miratimin e rregullores teknike për projektimin, instalimin dhe përdorimin e ashensorëve për transportin e njerëzve dhe/ose mallrave .

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme** ☐

Po ☐

Jo ☒

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkon)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

NUK KAM KERKESE PER PERJASHTIM

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:** ☐

NUK KAM

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.* ☐

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik**.

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

class.ashensor@yahoo.com

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Enkeledi Groballi